



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1040/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Milena Đerić Kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e paraqitur nga Burbuqe Berisha, kandidat për Kuvendin Komunal në Prizren nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1040/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Burbuqe Berisha, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimet 2004A/09R dhe 2005A/03R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1040/2021 nga Burbuqe Berisha, kandidat për Kuvendin Komunal në Prizren nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në të cilën thekson se në qendrën e votimit 2005A/03R ka pasur 10 vota në FPR të publikuara nga KQZ, ndërsa në rinumërim janë rinumëruar vetëm 1 votë, ndërsa në qendrën e votimit 2004A/09R pretendon se ka pasur 4 vota në FPR të publikuara nga KQZ ndërsa në rinumërim është numëruar vetëm 1 votë. E njëjta kërkon që të kontrollohen edhe njëherë se mos është gabim teknik apo i qëllimshëm sepse me këto vota e humb vendin në asamble komunale në Prizren. Si dëshmi ka bashkangjitur formularët e rezultateve të kandidatëve.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saja, nuk ka ofruar ndonjë provë bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mungesë të votave, ndërsa Paneli pasi që hulumtoi Formularët e Rezultateve të Kandidates të publikuara nga KQZ për vendvotimin 2004A/09R gjeti se e njëjta i ka pasur 1 votë e jo 4 vota ashtu siç pretendon edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mungesë të votave për kandidaten në fjalë, për faktin se thëniet e saja janë vetëm supozime dhe sipërfaqësore dhe jo të konkretizuara me asnjë provë konkrete bindëse për të cilën ajo pretendon për mungesë të votave .

Po ashtu kërkesa për rinumërimin e votave për vendvotimin: 2005A/03R është i pa bazuar për faktin se për të njëjtin vendvotim, KQZ-ja veç ka marrë vendim për rinumërim para se rezultati përfundimtar të publikohet andaj të njëjtat janë të rinumëruara, për këto arsye paneli vlerëson se një rinumërim tjetër për të njëjtin vendvotim të rinumëruara nga KQZ-ja në QNR, është i pa arsyeshëm, për më tepër ankuesja nuk ka ofruar prova shkresore që do ta argumenton se parregullsitë kanë ndodhur me rastin e rinumërimit andaj si te tilla këto pretendime janë të paqëndrueshme


Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Burbuqe Berisha nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega Prizren, nuk është i bazuar me asnjë provë apo dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi në vota për vendvotimet e lartcekura.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1040/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuese e Paneli

Milena Đeđić



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.